



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:219961

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05742504

**C.nr.196/17**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses D. B. Sh.nga fshati B./Malishevë, të cilën me autorizim e përfaqëson Daut Krasniqi avokat nga Malisheva, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” me seli në Prishtinë, rruga “Demokracia” nr.20, me objekt kontesti “Kompensim i dëmit të pësuar në aksident trafiku”, vlera e kontestit 2,490.00 (dymijë e katërqind e nëntëdhjetë) euro, në seancën e mbajtur me datë 27 maj 2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET** se paditësja D. B. Sh.nga fshati B./Malishevë, **e ka tërhequr padinë** që identifikohet në këtë gjykatë me shenjën C.nr.196/17 e datës 19.06.2017, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” me seli në Prishtinë.

**A r s y e t i m**

Paditësja D. B. Sh.nga fshati B./Malishevë, përmes të autorizuarit të saj Daut Krasniqi avokat në Malishevë, me datë 19.06.2017 në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: “Kompensim i dëmit të pësuar në aksident trafiku”, vlera e kontestit 2,490.00 euro.

Lidhur me këtë, gjykata me datë 27.02.2024 ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtin ia ka dërguar të paditurës, e cila nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa me datë 27.05.2024 me fillim prej orës 14:00, gjykata e ka caktuar seancën përgatitore, ku asnjëra nga palët nuk ka qenë prezentë.

Në procesverbalin e seancës përgatitore është konstatuar se i autorizuari i paditëses ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe kjo vërtetohet sipas fletë kthesës së datës 15.05.2024, por në seancë nuk është paraqitur askush, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe shtyrjen nuk e ka kërkuar, e në të cilën seancë nuk ka qenë prezent askush as nga e ana e të paditurës për të cilën nuk ka prova se është ftuar në mënyrë të rregullt.

Në procesverbal gjithashtu është konstatuar se përfaqësuesi i paditëses, në po të njëjtën datë, pra me datë 27.05.2024 e ka dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësën për tërheqjen e padisë

në këtë çështje juridiko-kontestimore, duke e njoftuar gjykatën se me të paditurën kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit dhe e ka realizuar kompensimin e dëmit në tërësi, andaj ka kërkuar tërheqjen e padisë së parashtruar pranë kësaj gjykate.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 par.1 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.2 të LPK-së, ku parashihet se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohej për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*.

Bazuar në faktin se paditësi e ka tërhequr padinë para se e paditura të paraqes përgjigje në padi, atëherë gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Andaj, në një gjendje të këtillë, Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 par. 2 dhe 3 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.196/17, datë 27.05.2024**

**G j y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**Udhëzim juridik:** *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*